

Miratohet vendimi për caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e Diasporës në Konsullatat Shqiptare në Itali dhe Greqi

Miratohet vendimi për caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e Diasporës në Konsullatat Shqiptare në Itali dhe Greqi. Me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën është miratur caktimi i oficerëve koordinues pranë posteve konsullore të Republikës së Shqipërisë në Romë, Athinë, Milano dhe Selanik lidhur me çështjet e Diasporës shqiptare në fushën e kulturës, arsimit, financës dhe drejtësisë. Oficerët koordinues për Diasporën do të kenë mbështetje dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me Agjencinë Kombëtare të Diasporës, Qendrën e Botimeve për Diasporën dhe Dhomën e Biznesit të Diasporës në adresimin e çështjeve të caktuara në fushat e veprimit. Fushat e veprimit të oficerëve koordinues do të përfshijnë zhvillimin e marrëdhënieve me komunitetin shqiptar në vendet pritëse, identifikimin e nevojave për arsimimin dhe komunikimin me mësuesit e gjuhës dhe kulturës shqipe në këto komunitete, nxitjen dhe organizimin e bizneseve shqiptare në vendin pritës si dhe në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për Drejtësinë do të kenë përqendrim ndikimin në identifikimin dhe asistimin e shtetasve shqiptarë, të cilët vuajnë heqjen e lirisë jashtë shtetit.

Vendimin e plotë mund ta lexoni [këtu](#).



Zhvilloi punimet konferenca

“Itali dhe Shqipëri, një portë e hapur në Ballkan”



Ky aktivitet, nisi me një minutë heshtje në nderim të viktimave tërmetit në Shqipëri, ka për qëllim nxjerrjen në pah të marrëdhënieve të mira të miqësisë dhe bashkëpunimit mes dy vendeve tona ndër vite, u organizua nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në bashkëpunim me Universitetin eCampus, Ambasadën Italiane në Shqipëri dhe me mbështetjen e veçantë të Ministrit të Shtetit për Diasporën. Gjatë fjalës përshëndetëse, ministri Majko u ndal në historinë e hershme të marrëdhënieve dy palëshe. “Ura është simbolika më e gjetur mes dy vendeve dhe situata në të cilën kaloi vendi ynë kalohet pikërisht nëpërmjet urave të miqësisë siç është kjo mes dy vendeve tona. Sot ka studentë shqiptarë që studiojnë në Itali, biznese shqiptare që janë hapur në Itali dhe nga ana tjetër biznese italiane të hapura në Shqipëri dhe universitete italiane që vijnë në Shqipëri”, u shpreh ministri Majko. Më tej, ai shtoi se sot janë mbi 500 mijë shqiptarë që jetojnë dhe punojnë në Itali.

Marrëveshje auditi me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë



Ministri i Shtetit për Diasporën firmosi marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për kryerjen e shërbimit të auditit të brendshëm në institucionet në varësi të tij. Sipas kësaj marrëveshje, institucionet në varësi të Ministrit të Shtetit për Diasporën do t’iu nënshtrohen procedurave të auditimit, me qëllim kontrollin, verifikimin dhe zbatimin korrekt të procedurave të brendshme të secilit institucion. Pas përfundimit të procesit të auditimit do të kryhet hartimi i konstatimeve që kanë rezultuar nga auditimi dhe rekomandimet. Ky proces realizohet me qëllim mbështetjen e këtyre institucioneve në arritjen e objektivave të tyre, ofrimin e këshillimit dhe rekomandimeve për të përmirësuar veprimtarinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga këto njësi publike. Marrëveshja e firmosur mes këtyre dy institucioneve është realizuar me qëllim krijimin e një sistemi mirëqeverisës në vend, dhe krijimin e një sistemi të brendshëm eficient në të gjitha institucionet publike. Marrëveshjen e plotë mund ta lexoni [këtu](#).

Takimi me grupin e arkitektëve dhe inxhinierëve shqiptarë nga Amerika



Gjatë takimit me grupin e arkitektëve dhe inxhinierëve shqiptarë të ardhur nga Nju-Jorku vullnetarisht në Shqipëri për të dhënë kontributin e tyre profesional në vlerësimin e çerdheve, shkollave dhe ndërtesave të tjera në zonat e prekura nga tërmeti. Grupi i ekspertëve shqiptaro-amerikanë u shpreh i gatshëm që në të ardhmen të përcjellë përvojën dhe dijen që disponon në funksion të zhvillimit të vendit të origjinës.



Gjatë takimit me kryetarin e Bashkisë së Saronikës në Atika të Greqisë, z. Petros Filippou (arvanitas), i cili ka sjellë ndihmat e grumbulluara nga shtatë Bashkitë e Atikës për familjet shqiptare të prekura nga tërmeti.



Në një takim me profesoreshën Aya Kubota nga Departamenti i Zhvillimit Urban i Universitetit të Tokios në Japoni dhe arkitektin shqiptar në Japoni Dastid Ferati, u zhvillua një bashkëpunim për situatën e shkaktuar në vendin tonë pas tërmetit.

Vizita në Holandë / Në aktivitetin për festat kombëtare dhe aktiviteti “Xhubleta”



Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko mori pjesë në aktivitetin për festat kombëtare dhe aktivitetin “Xhubleta”, organizuar nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Hagë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Diasporës. Në fjalën e tij, ministri Majko u shpreh për situatën që po kalon vendi ynë në këtë periudhë, duke falenderuar për mbështetjen miqëse ndërkombëtare dhe qeveritë e vendeve mike, në veçanti duke u ndalur në marrëdhënien miqësore mes dy vendeve. “Njerëzit kanë rifilluar jetën në Tiranë, Durrës, Lezhë zona që janë në situatë emergjence, shkollat do të rihapen, jeta do të vazhdojë, njerëzit do vazhdojnë bizneset e tyre. E ardhmja është e të gjithëve”, - u shpreh ministri Majko. Aktiviteti është zhvilluar në kuadër të kalendarit të aktiviteteve të planifikuara nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.


Në Forumin e Biznesit “Shqipëria, porta e Ballkanit” në Holandë



Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko mori pjesë në Forumin e Biznesit që u zhvillua në Rotterdam të Holandës me temë “Shqipëria, porta e Ballkanit”. Duke u ndalur fillimisht te situata në të cilën gjendet vendi ynë, ministri Majko tha se në të tilla situata nuk duhet humbur koha duke menduar për atë që ndodhi, por duhet të shohim përpara me shpresë: “Një pjesë e Tiranës është e dëmtuar, Durrësi në pjesën më të madhe të tij, por kjo nuk duhet të na pengojë që të shohim përpara, të shpresojmë dhe të vazhdojmë me të fortë se kurrë. Kjo është dhe arsyeja përse në javën e kaluar nuk e anuluan krijimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës, dhe vendosëm të vazhdojmë përpara, për të mos humbur shpresat për zhvillimin e Shqipërisë dhe shqiptarëve”, u shpreh ai.

Aplikacioni informues “Diaspora Shqiptare”

“Diaspora Shqiptare”



App store [këtu](#); Play store [këtu](#);

“Raporto” problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#); Play store [këtu](#);

Për të kontribuar në ndihmë të familjeve të prekura nga tërmeti



Kontributet vullnetare dhe ndihmat për familjet, mund të bëhen me shpejtësi në rrugë digjitale, në tre kategoritë e veçanta të hapura për grumbullimin e ndihmave në portalin “e-Albania”.